

LIGJ
Nr.7383, datë 8.5.1990

PËR GJYKATAT SHOQËRORE

Për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet shtetasve dhe për parandalimin e veprave penale e të konflikteve gjyqësore

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pranë këshillave popullore të fshatrave, të lagjeve të qyteteve dhe të qyteteve që nuk kanë lagje, veprojnë gjykatat shoqërore, të cilat shqyrtojnë për të zgjidhur me pajtim çështje për vepra penale që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit, çështje civile të caktuara dhe mosmarrëveshje të ndryshme ndërmjet shtetasve.

Neni 2

Gjykatat shoqërore zgjidhen për tre vjetnë mbledhjen e popullit me vota të hapura e me një numër anëtarësh prej jo më pak se 5 vetë. Në përbërjen e këyre gjykatave marrin pjesë veprimtarë shoqërorë nga organizatat e masave, që gëzojnë autoritet e besim në popull.

Gjykatat shoqërore i shqyrtojnë çështjet me pjesëmarrjen e jo më pak se 3 anëtarëve të caktuar nga këshilli popullor i fshatit, i lagjes së qytetit e i qytetit që nuk ka lagje.

Neni 3

Gjykatat shoqërore pranë këshillave popullore të fshatrave, të lagjeve të qyteteve dhe të qyteteve që nuk kanë lagje, shqyrtojnë për të zgjidhur me pajtim çështje lidhur me këto vepra penale të parashikuara nga Kodi Penal:

1. Plagosjen e lehtë nga pakujdesia (neni 176).
2. Rrahjen (neni 177).
3. Heqjen e paligjshme të lirisë (neni 181).
4. Dhunimin e banesës (neni 183).
5. Kanosjen (neni 184).
6. Fyerjen (neni 185).
7. Shpifjen (neni 186).
8. Shtrëngimin për martesë (neni 191).
9. Shkeljen e detyrimeve familjare (neni 1949).
10. Shpërdorimin e pasurisë (neni 195).
11. Vetëgjyqësinë (neni 210).

Neni 4

Gjykatat shoqërore pranë këshillave popullore të fshatrave, të lagjeve të qyteteve dhe të fshatrave, të lagjeve të qyteteve dhe të qyteteve që nuk kanë lagje, shqyrtojnë për të zgjidhur me pajtim këto çështje civile ndërmjet shtetasve:

1. Për pagimin e detyrimeve deri në 1500 lekë, që lindin nga kontratat ose nga shkaktimi i dëmeve.
2. Për shpërblimin e dëmit në bujqësi gjer në 1500 lekë.
3. Për zgjidhjen e martesave dhe mospërmushjen e detyrimeve për ushqim.

4. Për pjesëtimin e pasurisë së luajtshme.
5. Për cenimin e pronësisë.

Neni 3

Kompetente për shqyrtimin e çështjeve penale është gjykata shoqërore e fshatit, e lagjes së qytetit ose e qytetit që nuk ka lagje, ku ka ndodhur vepra penale. Megjithatë, gjykata shoqërore e vendit të ngjarjes, ku çmon se shqyrtimi i veprës penale do të ushtrojë një ndikim më të madh për pajtim, ia dërgon çështjen, nëpërmjet këshillit popullor, gjykatës shoqërore të vendit ku ka banimin personi i akuzuar.

Kompetente për shqyrtimin e çështjeve civile është gjykata shoqërore e fshatit, e lagjes së qyteit ose e qytetit që nuk ka lagje, ku kanë banimin të dy palët. Kur palët kanë banime të ndryshme, çështja mund të shqyrtohet nga gjykata shoqërore e vendit ku ka banimin i padituri ose nga gjykata e rrethit.

Neni 6

Gjykatat shoqërore i shqyrtojnë çështjet e kompetencës së tyre brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së paraqitur në këshillin popullor përkatës.

Organet shtetërore dhe organizatat shoqërore që marrin kërkesa për çështje penale e civile të përcaktuara në nenet 3 e 4 të këtij ligji, detyrohen t'ia dërgojnë ato menjëherë i këshillit popullor, pranë të cilit vepron gjykata kompetente shoqërore.

Neni 7

Për çështjet e mësipërme penale e civile gjykata shoqërore, me të marrë kërkesën, bën të gjitha përpjekjet për pajtimin e palëve.

Kur palët pranojnë të pajtohen dhe ky pajtim nuk vjen në kundërshtim me ligjin e me rregullat e bashkëjetesës socialiste, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga palët dhe nga tre anëtarët e gjykatës. Në këto raste palët nuk mund t'i drejtohen më pas gjykatës së rrethit.

Në çështjet civile, me përjashtim të zgjidhjes së martesave, procesverbali i pajtimit përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

Kur nuk arrihet pajtimi, pala e interesuar mund t'i drjtohet gjykatës së rrethit për zgjidhjen e çështjes, sipas rregullave të përcaktuara në kodin e procedurës Penale ose Civile. Në këto raste gjykatat shoqërore ia dërgojnë menjëherë dokumentet përkatëse gjykatës së rrethit.

Neni 8

Për procesverbalet e paligjshme të pajtimit, për çështjet penale mund të bëhet kërkesë nga prokurori i rrethit në gjykatën e rrethit jo më vonë se dy muaj nga ndodhja e veprës, kurse për çështjet civile veprohet në rrugën e kundërshtimit të titullit ekzekutiv.

Neni 9

Këshilli i Ministrave, ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe këshillat popullorë të rretheve, brenda datës 30 shtator 1990, të studiojnë aktet ligjore e të rishikojnë aktet nënligjore të nxjerra prej tyre, në të cilat parashikohen kundërvajtjet administrative në kompetencë të gjykatave të fshatrave, të qyteteve e të lagjeve të qyteteve, për t'i kaluar këto në kompetencë të organeve të administratës shtetërore.

Neni 10

Dekreti nr.4426, datë 23.9.1968 "Për gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve", shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1990.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA